



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR

TIRANË

NR. 3051 S.P./4064 AKTI

NR. 3469 VENDIMI

Dt. rregj. 23.11.2021 SP/ 20.12.2021 regj.them.

Dt. 20.12.2021

V E N D I M

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane, me trup gjykues të përbërë nga:

GJYQTARI: SOKOL PASHO

asistuar nga sekretare gjyqesore Etleva Avdia, me pjesëmarrjen e prokurorit Arian Permeti sot me date 20.12.2021, mori në shqyrtim çështjen penale që i përket:

I PANDEHUR : Ruzhdi Morinaj, i biri i Hasan dhe Bore, i dtl. 25.11.1991, lindur ne Shikaj dhe banues në Tiranë, Rr. Faik Halil Hoxha, banesë private nr.10, me shtetësi shqiptare, i martuar, me arsim të mesem, i padënuar, i identifikuar me pasaporten me nr. personal I91125063G, i mbrojtur në gjykim nga av. Lazer Sokoli, Anëtar i Dhomës së Avokatisë Tiranë, me nr. 1128 license.

AKUZUAR: Për veprën penale “Drejtimi automjeteve ne menyre te parregullt”, te parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Gjykata, pasi pranoi kërkesën e përfaqësuesit të pandehurit për gjykim të shkurtuar dhe në përfundim dëgjoi prokurorin që kërkoi deklarinim fajtor të të pandehurit për sa akuzohet dhe dënimin e tij me 9 muaj burgim, dhe aplikimin e nenit 406 K.Pr.Penal dhe nenit 59 Kodi Penal, si dhe pasi dëgjoi edhe avokatin e të pandehurit i cili deklaroi se ishte dakort me prokurorin

V E R E N

Se Prokuroria i është drejtuar Gjykatës me kërkesën Nr. 3051 Akti, datë 23.11.2021 regjistrimi me objekt: Dërgimin në gjyq të çështjes penale që i përket procedimit penal me nr. 3813 të vitit 2021, në ngarkim të të pandehurit Ruzhdi Morinaj, i akuzuar për veprën penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i K.Penal, duke i bashkëlidhur kërkeses edhe aktet dhe provat që përmban fashikulli përkatës.

I pandehuri gjatë hetimeve paraprake nuk ka paraqitur kontestime, ndërsa në seancën paraprake, përfaqësuesi i tij me prokurë të posacme, kërkoi gjykim të shkurtuar, duke pranuar që gjykimi të zhvillohet në gjëndjen që janë aktet në fashikullin e Prokurorisë të sjellë për gjykim, ndaj dhe Gjykata bazuar në nenet 405 dhe 406 të K.Pr.Penale, u shpreh dakord që të procedohet me gjykim të shkurtuar, duke çmuar për zgjidhjen e çështjes penale në gjëndjen që janë paraqitur aktet nga Organi i Prokurorisë, pasi nga palët nuk pati pretendime pavlefshmërie, papërdoshmërie, për aktet si dhe të tjera kërkesa paraprake të kësaj natyre.

Gjykata, në respektim të dispozitave ligjore (nenit 405 të K.Pr.Penale), duke vlerësuar se aktet janë të plota dhe se çështja mund të zgjidhet në gjëndjen në të cilat ndodhen këto akte, vendosi zhvillimin e gjykimit të shkurtuar, duke pranuar kërkesën e bërë nga i pandehuri.

Në mbështetje të dispozitave të posaçme procedurale si dhe të Vendimit Unifikues Nr.2, datë 29.01.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, ky lloj gjykimi i posaçëm eviton marrjen e provave në seancë gjyqësore dhe debatin lidhur me to. Në këto kushte fashikulli (dosja) e prokurorit kthehet në dosje gjyqësore duke marrë vlerën e provës pas pranimit të kërkesës për gjykim të shkurtuar. Në këtë fashikull bazohen konkluzionet përfundimtare të palëve si dhe gjykata në dhënien e vendimit.

Nga aktet e administruara rezulton se, në datën 28.05.2021 rreth orës 00:05 në rrugën Tirane-Elbasan pranë vendit të quajtur “Liqeni i Thatë”, punonjësit e policisë së Sektorit të Forcës së Posaçme Shqiponja kanë ndaluar dhe kanë ushtruar kontroll ndaj mjetit me targë AA 646YR. Në mjet ndodhej drejtues i mjetit i pandehuri Ruzhdi Morinaj, i cili në momentin që ka kontaktuar punonjësit e policisë ka pasur sjellje të dyshimta. I është bërë kontrolli i mjetit dhe në të, poshtë sediljes është gjetur një qese e tejdukshme me pluhur të bardhë e dyshuar si lëndë narkotike kokainë. Nga punonjësit e policisë gjyqësore është bërë kontroll në banesën e shtetasit. Në dhomën e gjumit, në sirtarin e parë të komedinës, është gjetur një peshore elektronike.

Lënda pluhur e dyshuar lëndë narkotike është sekuestruar me cilësinë e provës materiale. Nga peshimi i saj, fakt i pasqyruar në procesverbalin e peshimit lëndës datë 28.05.2021, rezulton se lenda e sekuestruar kishte një peshë të përgjithshme 0.4 gram se bashku me amballazh. Pas peshimit, lënda e sekuestruar është futur ne qesen e provave me nr. Unik B20002370.

Personit nen hetim i është marrë për ekspertim toksikologjik, “mostër urine”, e futur në qesen e provës me nr. unik B 20002368.

Në deklarinimin e tij personi nën hetim deklaroi se prej 2 muajsh është përdorues i lëndës narkotike. Lënda narkotike që i është gjetur e kishte blerë te një shtetas ne Laprakë të cilin mund t’u identifikoj nëse e shikon. Përsa i takon peshores së gjetur në banesë, shtetasi sqaron se e ka blerë për një shumë 500 leke te tregu cam, për të mbajtur nën kontroll sasinë e lëndës narkotike që konsumon.

Nga akti ekspertimit toksikologjik nr. 1268 datë 10.06.2021 rezulton se : *Në mostren e urinës marrë shtetasit Ruzhdi Morina, futur në kontenier dhe mbyllur në qesen e provave me nr. B20002368, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të cocainës (benzoilkgonine) në organizmin e njeriut.*

Gjate hetimit u kryen edhe veprime hetimore lidhur me lëndën narkotike, për të sqaruar nëse lënda narkotike ishte për përdorim vetjak.

Nga akti ekspertimit kimik lënde nr 7858 date 09.08.2021, për provën materiale futur në qese prove nr. B20002370 rezulton se :

- *Analiza me GC/MS per materialin objekt ekspertimi tregoj praninë e kokainës.*

- *Pesha pa ambalazh e materialeit, objekt ekspertimi është 0.331 gr.*

Nga akti ekspertimit kimik lëndë nr. 7861 date 09.08.2021, për proven materiale futur në gese prove nr B20002369 rezulton se :

- *Analiza me GC/MS per materialin objekt ekspertimi tregoj përjetje të kokainës.*

Nga akti ekspertimit mjekoligjor nr. 2341 datë 05.10.2021 (klinikist) konkludohet se :

- *Ndarja e lëndes narkotike në doza nuk është objekt i ekspertimit mjekoligjor. Dozat e helmimit akut fillojnë kur sasia e kokainës është në masën mbi 500 miligram. Në rastin konkret sasia 331 miligram kokainë rruond të konsumohet menjëhere dhe si e tillë konsiderohet si dozë e vogël për përdorim vetjak, pa shkaktuar dëmtime për shëndetin.*

Në përfundim të hetimeve lidhur me këtë çështje prokurori ka argumentuar se në këto kushte konstatohet se nuk jemi para elementëve të veprës penale “**Prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike**”, neni 283/1 i K.Penal pasi jemi para rastit përjashtimor që kjo dispozitë parashikon për personat që mbajnë lëndë narkotike për përdorim personal në doza të vogla dhe që nuk mbajnë përgjegjësi penale. Në analizë të provave, lidhur me këtë fakt, ndaj të pandehurit Ruzhdi Morina, nuk mund të ngrihet akuze edhe për veprën e parashikuar nga neni 283/1 i K.Penal.

Në këto rrethana dhe nga provat e e administruara gjatë fazës së hetimit paraprak rezulton plotesisht e e provuar se shtetasi Ruzhdi Morinaj ka konsumur elementët e veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", e parashikuar nga neni 291 të K.Penal.

Këto rrethana provohen me:

- Procesverbali i kapjes në flagrance i shtetasit datë 28.05.2021.
- Raport shërbimi datë 28.05.2021.
- Procesverbal i kontrollit të vendeve datë 28.05.2021.
- Procesverbal i sekuestrimit datë 28.05.2021.
- Urdhër për kthimin e mjetit datë 28.05.2021.
- Procesverbal marje prove materiale datë 28.05.2021.
- Procesverbal i peshimit të provës materiale 28.05.2021.
- Procesverbal i marjes së mostrës së urinës për ekspertim 28.05.2021
- Procesverbal i marjes së dokumenteve datë 28.05.2021.
- Akt ekspertimi toksikologjik datë 11.06.2021.
- Akt ekspertimi kimik lëndë nr. 7858 datë 09.08.2021.
- Akt ekspertimi kimik lëndë nr. 7861 datë 09.08.2021.
- Akt ekspertimi mjekoligjor nr. 2341 date 05.10.2021.
- Si dhe të gjitha materialet e tjera që përmban fashikulli hetimor i çështjes penale në ngarkim të tij.

Mbi bazën e këtyre fakteve nga akuza u kërkua deklarimi fajtor i të pandehurit Ruzhdi Morinaj, për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i K.Penal dhe dënimi i tij, në masën e përcaktuar në pjesën hyrëse të këtij

vendimi, duke parashtruar se me veprimet e tij të kryera me dashje, i pandehuri ka konsumuar elementët e veprës penale të parashikuar nga neni 291 të K.Penal.

Arsyetimi i Gjykses, argumentat juridike, interpretimi i dispozitave penale, analiza e provave.

E ndodhur përpara këtyre parashtrimeve, përcaktimit të faktit dhe provave në gjykim, Gjykata çmon se veprimet e të pandehurit Ruzhdi Morinaj, plotësojnë të gjithë elementët që kërkon legjislacioni penal shqiptar për t'i cilësuar këto veprime si elementë të figurës së veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i K.Penal.

Në përmbajtjen e nenit 291 të K.Penal, sanksionohet se:

"Drejtimi i automjeteve apo mjeteve të tjera të motorizuara në gjendje të dehur, nën efektin e lëndëve narkotike apo pa dëshminë përkatëse të aftësisë dënohet me burgim nga dhjetë ditë deri në tre vjet.

Gjykata mund të vendosë zëvendësimin e dënimit me burgim me pagimin e një shume të hollash në favor të shtetit."

Elementët e konsumuar nga ky i pandehur, pjesë përbërëse të kësaj vepre penale, rezultojnë si më poshtë:

Objekti i veprës penale, janë marrëdhëniet juridike, të cilat janë vendosur për të siguruar dhe garantuar mbarëvajtjen dhe ecurinë e lëvizjes së automjeteve në respektim të normave ligjore, me qëllim mbrojtjen e jetës dhe të shëndetit si të këmbësorëve ashtu edhe të drejtuesve të automjeteve, si dhe të respektimit dhe funksionimit të shtetit ligjor konform rregullave dhe procedurave ligjore përkatëse.

Nga ana objektive, kjo vepër penale, është konsumuar nga i pandehuri Ruzhdi Morinaj, me veprime konkrete, duke përdorur automjetin në efektin e lëndëve narkotike. Nga akti ekspertimit toksikologjik nr. 1268 datë 10.06.2021 rezulton se : Në mostren e urinës marrë shtetasit Ruzhdi Morina, futur në kontenier dhe mbyllur në qesen e provave me nr. B20002368, u zbulua prania e produkteve të metabolizmit të cocainës (benzoilkgonine) në organizmin e njeriut.

Subjekti i kryerjes së kësaj vepre penale është i pandehuri, që nga hetimi gjyqësor rezultoi të jetë i përgjegjshëm para ligjit penal dhe ka mbushur moshën për përgjegjësi penale. Gjykata, konstaton se mosha madhore, si dhe përgjegjshmëria e të pandehurit, e bën atë të jetë përpara kritereve ligjore për të mbajtur përgjegjësi për këtë vepër penale.

Nga ana subjektive, vepra penale është kryer nga i pandehuri me faj në formën e dashjes direkte pasi i pandehuri ka parashikuar kundërligjshmërinë e veprimeve të tij dhe pasojat e veprës.

Referuar, analizës juridike si më sipër, Gjykata vlerëson se për shkak të bindjes së saj të krijuar mbi provat e administruara në gjykim mbi fajësinë e plotë të të pandehurit Ruzhdi Morinaj, në veprimtarinë e kundërligjshme të analizuar më sipër, në rastin konkret vepra penale për të cilën akuzohet i pandehuri është kualifikuar drejt nga organi i akuzës sipas cilësimit të duhur juridik, të konkluduar nga konsumimi prej të pandehurit i të gjithë elementëve të figurës së veprës penale "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt", të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal.

Lidhur me llojin dhe masën e dënimit që duhet të caktohet për të pandehurin Ruzhdi Morinaj, Gjykata merr në konsideratë rrezikshmërinë shoqërore të veprës penale e reflektuar në rëndësinë e marrëdhënieve juridike që prek, menyrën dhe formën e kryerjes së veprës penale.

Gjykata bazuar në nenet 47, 48, 49, të K.Penal, merr parasysh, shkallën dhe formën e fajit të të pandehurit në kryerjen e veprës penale, si dhe rrezikshmërinë shoqërore të të pandehurit, rezulton se i pandehuri ka qenë i dënuar më parë, si dhe pendimin e tij.

Gjithsesi, në një vlerësim të hollësishëm të përmbajtjes, konstatimeve si dhe të të gjitha rrethanave të kryerjes së veprës penale nga i pandehuri, Gjykata konkludoi se lloji dhe masa e dënimit me burgim për të pandehurin Ruzhdi Morinaj, është në raport të drejtë me vlerësimin e rrethanave të kryerjes së veprës penale.

Kështu, lidhur me masën e dënimit me burgim që duhet të caktohet ndaj të pandehurit, Gjykata, çmon se dënimi të pandehurit me 6 muaj burgim do të ishte i përshtatshëm, pasi në një vlerësim të hollësishëm të rrethanave të mësipërme të çështjes të analizuar prej saj, dhënia e masës së dënimit me burgim të përcaktuar nga neni 291 të K.Penal, çmohet nga Gjykata se do të realizojë njëkohësisht jo vetëm qëllimin e ndëshkimit të të pandehurit për veprën penale të kryer, por edhe atë të rehabilitimit, edukimit dhe riintegritimit të të pandehurit në të ardhmen në shoqëri.

Në bazë të nenit 30/3 dhe 37 të K.Penal, të pandehurit Ruzhdi Morinaj, i hiqet e drejta për të drejtuar automjete për një periudhë kohore prej 1 (një) viti.

Për sa i përket shpenzimeve gjyqësore ato duhet t'i ngarkohen të pandehurit, pasi atij i referohet dënimi në zbatim të nenit 393 të K.Pr.Penale.

Për sa u analizua u provua me pretendimet e palëve në seancë dhe provat shkresore të ndodhura në dosje pjesë përbërëse e fashikullit gjyqësor.

PËR KËTO ARSYE

Në vështrim të neneve 379, 384, 390, 405 e 406 të K.Pr.Penale dhe neneve 291 të Kodit Penal, Gjykata:

V E N D O S I:

- Deklarimin fajtor të të pandehurit Ruzhdi Morinaj, për kryerjen e veprës penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt”, të parashikuar nga neni 291 i Kodit Penal dhe dënimin e tij, me 6 (gjashtë) muaj burgim.
- Në zbatim të nenit 406/1 të K.Pr.Penale, i zbritet 1/3 e dënimit, duke e dënuar përfundimisht të pandehurin Ruzhdi Morinaj, me 4 (katër) muaj burgim, dënim të cilin i pandehuri e ka vuajtur me kohën e paraburgimit.
- Në bazë të nenit 260/1/c të K.Pr.Penale shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në shtëpi” për të pandehurin Ruzhdi Morinaj, caktuar me vendimin me nr. 855 Akti, datë 31.05.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.
- Në bazë të nenit 37 të K.Penal, të pandehurit Ruzhdi Morinaj, i hiqet e drejta për të drejtuar automjete për një periudhë kohore prej 1 (një) viti.
- Shpenzimet proceduriale të fazës së hetimit paraprak, si dhe shpenzimet gjyqësore i ngarkohen të pandehurit.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në Gjykatën e Apelit Tiranë, brënda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja e njoftimit të tij.
- U shpall sot në Tiranë, më datë 20.12.2021.

SEKRETARE

GJYQTAR

ETLEVA AVDIA

SOKOL PASHO

Shpenzime procedurale të Prokurorisë

Vlera e totale e shpenzimeve 15000 lekë.

Shpenzimet gjyqësore

Njoftime 450 lekë